

mr. Rejhan Neziri

FAMILJA NË ISLAM

Kreuzlingen,
janar, 2006

HYRJE

Përse familja? Përse nëpër rrugët kryesore të qyteteve shqiptare muslimane kanë filluar të ngjiten pankarta të mëdha me fotografinë e një foshnje ku shkruan “DUA FAMILJE”? Përse nëpër vendet ku banojnë shqiptarët muslimanë janë hapur lokale ku veprojnë prostituta të huaja, të cilat vetëm nga një komunë e shqiptarëve muslimanë për në vendet nga kanë ardhur transferojnë shuma parash të mëdha që arrijnë shifrën edhe prej 10.000.000 € (dhjetë milionë euro) në vit, ndërkohë që buxheti vjetor i komunës së caktuar është vetëm 2.000.000 € (dy milionë euro)?* Përse numri i shkurorëzimeve është në rritje e sipër te shqiptarët muslimanë? Përse numri i të varurve prej drogës është gjithnjë në rritje te shqiptarët muslimanë? Përse në familjet shqiptare muslimane po vërehet një zbehje e dashurisë, një ftohje e marrëdhënieve të anëtarëve të saj? Përse vërehet indiferenca, mosçarja e kokës për gruan e fëmijën te shumë të rinj të martuar shqiptarë muslimanë? Përse në mesin e shqiptarëve muslimanë janë paraqitur sëmundje të ndryshme që të parët tanë s’kanë dëgjuar kurrë për to, siç është, p.sh. SIDA? Përse...?

Këto dhe një varg pyetjesh të tjera si këto, domosdo na parashtrohen dhe me to ndeshemi pothuajse në çdo hap të jetës sonë. Është paraqitur një sëmundje e cila po rëndon mbi shoqërinë muslimane shqiptare dhe e cila ka një spektër të gjerë veprimi në të gjitha sferat e jetës. Vërehet një lëkundje e themeleve dhe bazave të shoqërisë sonë, lëkundja e themeleve të mini-shoqërisë që është familja, e cila domosdo në një të ardhme të afërt mund të karakterizohet me shembjen dhe rënien e tërë shoqërisë sonë. Janë këto simptomat e kësaj sëmundjeje e lëngate prej të cilave ka filluar të dërgjë familja muslimane shqiptare, të cilat na detyrojnë që me seriozitetin më të madh t’i qasemi kësaj çështjeje nga të gjitha aspektet e saj, si nga ai fetar, ekonomik, politik, shoqëror, shëndetësor, arsimor, psikologjik etj. etj. Familja shqiptare ka filluar të vuajë, pra, nga një lëngatë që kërkon intervenimin e shumë mjekëve të lëmive të ndryshme të jetës. Sigurisht që këtu në plan të parë ne e shohim intervenimin e përnjëkoshëm të teologut, sociologut, psikologut, politikanit, ekonomistit, pedagogut e të tjerëve që mund drejtpërdrejtë të ndikojnë në situatën e dhënë, e cila dikujt mund edhe të mos i duket edhe kaq tragjike sa e paraqitëm ose edhe sa po e vërejmë ne. Dikujt mund edhe t’i jenë verbëruar ose edhe t’i jenë ngazëllyer sytë nga jeta moderne dhe e shthurur, nga erërat e modernizmit e të

* Këto të dhëna vlejné për komunën e Ferizajit (Kosovë) të përmendura nga një aktivist politik e të cituara nga Qemajl Morina, “Roli i familjes në shoqërinë islame”, *Takvimi*, bot. Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë, viti 2003.

post-modernizmit që me të madhe po fryjnë në shoqërinë tonë, sa nuk e vëren vetveten as shoqërinë përreth se nga po shkon, kush po ia tërheq vijën e jetës e kush po ia planifikon mënyrën se si ai duhet të jetojë.

Duke u nisur nga përgjegjësia që e kam ndaj popullit tim musliman, e shoh të domosdoshme t'i qasem këtij problemi, pra jetës familjare, nga aspekti im, nga këndi i një sociologu të religjionit, për të hedhur dritë mbi çështjen dhe për të gjetur metodat e përshtatshme për kurimin e sëmundjeve të saj. Këtu në radhë të parë vijmë në shprehje metodat shkencore të sociologjisë së përgjithshme dhe të religjionit duke e përdorur në masë të madhe teknikën e krahasimit. Mua si sociolog i mundshëm musliman nuk më duket se jam sjellë joobjektiv, i anshëm kur është në pyetje institucioni shoqëror i familjes, kur po e marr më të shëndoshë sistemin familjar që na ofron Islami. Tekefundit kështu janë sjellur dhe kanë vepruar edhe nismëtarët e sociologjisë së përgjithshme e të asaj të religjionit në Perënim, si Emil Durkheimi, August Comte, Max Weberi, Le Play...e sidomos sociologët priftërinj të krishterë si Ernest Trölsch etj., punimet e të cilëve merren si shkencore dhe objektive.

Këtë punim të shkurtër e kam ndarë në katër mini-kapituj, për t'i shikuar së paku katër dimensionet e ndryshme të temës që po e shtjellojmë. Kapitulli i parë bën përshkrimin e institucionit të familjes nga aspekti sociologjik, si përkufizimin e familjes, klasifikimin e familjes nga aspekte të ndryshme, funksionet e familjes së gjerë tradicionale dhe të asaj të ngushtë bërthamore etj. Kapitulli i dytë bën përshkrimin e gjendjes së institucionit të familjes në Perëndim, llojin e kësaj familjeje dhe problemet bazë të saj. E kam zgjedhur këtë, ngase për momentin unë vetë jetoj në Perëndim dhe ngase edhe bashkëkombasit e mi sytë e tyre i kanë drejtuar kah Perëndimi, në mos ardhshin këtu, së paku tentojnë të jetojnë si perëndimorët. Kapitulli i tretë bën përshkrimin e gjendjes së institucionit të familjes muslimane në përgjithësi, e të asaj shqiptare në veçanti, në vendlindje dhe në Perëndim, problemet dhe dhimbjet që i përjeton ajo si dhe anët e shëndosha të saj. Në kapitullin e katërt do ta plasojmë qëndrimin e Islamit ndaj këtij institucioni të rëndësishëm shoqëror e fetar, me shpresë që ne si shqiptarë muslimanë të vetëdijësohemi për identitetin tonë, se kush jemi dhe se kush duhet të vazhdojmë edhe më tej të jemi.

P Ë R M B A J T J A:

H Y R J E.....	2
P Ë R M B A J T J A.....	4
I. FAMILJA NGA ASPEKTI SOCIOLOGJIK.....	5
A. PËRKUFIZIMI I FAMILJES.....	5
B. LLOJET E FAMILJEVE.....	6
II. FAMILJA NË PERËNDIM.....	9
III. FAMILJA TE MUSLIMANËT.....	13
A. FAMILJA NË BOTËN MUSLIMANE.....	13
B. FAMILJA TE MUSLIMANËT SHQIPTARË.....	14
IV. FAMILJA NË ISLAM.....	15
A. PËRKUFIZIMI DHE PARIMET THEMELORE.....	15
B. STRUKTURA E FAMILJES ISLAME.....	18
C. FUNKSIONET DHE QËLLIMET E FAMILJES.....	20
PËRMBYLLJE.....	26
Literatura e konsultuar.....	27

I. FAMILJA NGA ASPEKTI SOCIOLOGJIK

A. PËRKUFIZIMI I FAMILJES

Termi ‘familje’ është një fjalë që ka kuptim dhe përdorim shumë të gjerë. Sa përdoret për të shprehur jetën e përbashkët të njeriut, po aq përdoret edhe për të shprehur bashkëjetesën dhe bashkëveprimin e gjallesave e sendeve të tjera si dhe llojin a gjininë e tyre, p.sh. të kafshëve, të bimëve, të gjuhëve, të profesioneve etj. Mirëpo, kur fjala ‘familje’ nuk përcillet nga përcaktorë të ndryshëm, si p.sh. familja e shtazëve grabitqare ose familja e gjuhëve indo-evropiane etj., porse përdoret e vetmuar, ajo zakonisht shpreh jetën e përbashkët të një grupi njerëzish. Kurse formacionet që nuk janë karakteristike për njeriun i quajmë ‘kohabitacion, bashkëjetesë’.

E pra, ç’është familja?

*“Familja është një institucion shoqëror që e siguron vazhdimin e llojit njerëzor si pasojë e marrëdhënieve biologjike, ku për herë të parë paraqitet procesi i socializimit, ku marrëdhëniet e ndërsjella lidhen me disa rregulla e norma, ku bëhet bartja (përcjellja) e pasurive dhe vlerave materiale e shpirtërore nga brezi në brez dhe që ka dimensionin e saj biologjik, psikologjik, ekonomik, shoqëror, juridik e të ngjashëm”.*¹

Pra, familja është një institucion shoqëror ku fillon jetën dhe ku bëhet riprodhimi i llojit njerëzor nëpërmjet martesës e marrëdhënieve intime të bashkëshortëve; ku fillon arsimimi, edukimi dhe vetëdijësimi i fëmijës – socializimi; ku secili anëtar e di se si duhet të sillet ndaj njëri-tjetrit, ndaj më të vjetrit, ndaj më të riut, ndaj grave, ndaj burrave, ndaj mysafirëve etj.; ku bëhet trashëgimia e pasurisë materiale dhe e bagazhit kulturor e fetar nga gjenerata në gjeneratë ...

Ky është një përkufizim që më së tepërmi i reflekton funksionet dhe qëllimet e familjes në shoqëri, për të cilat do të flasim më poshtë.*

Nisur nga fakti se si në të kaluarën ashtu edhe sot njeriu thuajse asnjëherë nuk ka jetuar i vetmuar, porse gjithmonë e kemi hasur të jetojë brenda një bashkësie të quajtur familje, përpara nesh na paraqiten disa lloje familjesh të tilla.

¹ İsmail Doğan, *Sosyoloji – Kavramlar ve Sorunlar*, Sistem yay., Stamboll, 1998, f. 194-195.

* Për një përkufizim tjetër të bërë nga dr. Hamude Abdulati shih më poshtë te ‘Familja në Islam’.

B. LLOJET E FAMILJEVE

Duke marrë parasysh disa kritere të caktuara, në lëmin e sociologjisë bëhet klasifikimi dhe ndarja e familjes si më poshtë:

1. Sipas madhësisë së saj, kemi:
 - a. Familje të gjerë (të madhe),
 - b. Familje bërthamë (të vogël), dhe
 - c. Familje të komponuar.
2. Sipas pozitës gjeografike, kemi:
 - a. Familje fshatare,
 - b. Familje të kasabasë (qytezës),
 - c. Familje qytetare,
 - d. Familje varoshare (periferike), dhe
 - e. Familje endacake
3. Sipas profesionit që ushtrojnë anëtarët e saj, kemi:
 - a. Familje e bujkut,
 - b. Familje e esnafit dhe e zanatçiu,
 - c. Familje e nëpunësit,
 - d. Familje borgjeze e aristokrate,
 - e. Familje kurbetqare,
 - f. Familje industriale etj.
4. Sipas asaj se kush e mban pushtetin në dorë, kemi:
 - a. Familje patriarkale,
 - b. Familje matriarkale,
 - c. Familje demokratike etj.

Tani të ndalemi pak në llojet kryesore të familjeve që dallohen e veçohen prej të tjerave me tipare të theksueshme.

1. a. Familja e zgjeruar (e madhe) dhe funksionet e saj:

Ky lloj i familjes në masë të gjerë haset në zonat rurale, fshatare e sidomos në shoqëritë e paraindustrializmit. Siç mund të paraqitet me gjerësinë horizontale e vertikale që bartet nga babai te nipërit, ashtu mund të zgjerohet edhe duke i përfshirë madje edhe farefisën e të afërmit. Ajo në vete mund të përfshijë babain, nënën, fëmijët e pamartuar e të martuar, gjyshin e gjyshen, hallat, mixhallarët etj. Përkundër familjes moderne apo qytetare e bërthamore, në familjen e gjerë brezat e rinj (fëmijët dhe nipërit e mbesat) mbahen nën kulmin familjar për një kohë mbase më të gjatë, edhe pas martesës së tyre.

Te familja e zgjeruar, që njihet edhe me emrin familje tradicionale, kryesisht janë të gjalla e të theksuara këto funksione të saj:

aa. Funksioni biologjik: Është funksioni i përbashkët i të gjitha llojeve të familjeve, me çka bëhet riprodhimi dhe shtimi i llojit njerëzor. Funksioni i lindjes së fëmijës për vazhdimin e llojit njerëzor i është dhënë familjes, ndaj në këto familje kryhet me sukses ky funksion.

ab. Funksioni ekonomik: Familja në të njëjtën kohë është njësi edhe prodhuese edhe konsumuese. Nëse e sjellim parasysh një shtëpi fshatare ose një shtëpi të vjetër zanatçiu, do të shohim se ajo familje reflekton pamjen e një punëtorie. Brenda familjes ka një ndarje të punës sipas moshës dhe gjinisë. Zoti i shtëpisë në të njëjtën kohë është edhe babë edhe shef (punëdhënës), kurse djali edhe bir edhe çirak.

ac. Funksioni autoritativ: Individu fiton autoritetin e respektin sipas pozitës që zë ai në familjen dhe në mjedisin farefisnor të cilëve u takon. Për të përcaktuar statusin e personit, pyesim ‘i cilës familje je?’. Në këto familje dihet qartë statusi i secilit, i babait si baba, i nënës si nënë etj. dhe secili meriton respektin e nderin sipas statusit që ka në familje. Te këto familje është shumë e theksuar ajo që e quajmë ‘ndjenja e përkatësisë’. Shumë fortë e ndjejnë se cilës familje dhe kujt i takojnë.

ad. Funksioni edukativ: Fëmija, kulturën e shoqërisë, njohuritë profesionale i merr në familje. Të mëdhenjtë e familjes kanë ndikim të veçantë e të padiskutueshëm në edukimin e fëmijës. Në këtë kuptim familja është një mjedis socializimi, ku fëmija me ndihmën e të rriturve bëhet anëtar i barabartë dhe i pjekur i shoqërisë.

ae. Funksioni mbrojtës: Në shoqëritë tradicionale përgjithësisht nuk ka forca sigurimi për të ruajtur sigurinë dhe qetësinë e individëve. Sulmeve që vijnë nga jashtë u dalin ballë bashkërisht të gjithë anëtarët e familjes. Për këtë arsye, në shoqëritë tradicionale ku kanë shtrirje të gjerë këto familje, me të madhe shihen hakmarrje gjaku.

af. Funksioni fetar: Familjet tradicionale nuk mjaftohen vetëm me ofrimin e edukatës dhe arsimit fetar te anëtarët e saj, porse ato edhe mbikëqyrin nëse anëtarët e saj i kryejnë ose jo detyrat praktike të fesë – pra luan rolin e një ‘mekanizmi kontrolli’ në këtë aspekt.

ag. Funksioni i ofrimit të qetësisë psikologjike: Lidhjet emocionale ndërmjet babait, nënës dhe fëmijëve sigurojnë arritjen e qetësisë e harmonisë psikologjike të anëtarëve të familjes. Në familjet tradicionale lidhjet psikologjike nuk janë të thella, por të gjera. Njeriu sa ka lidhje psikologjike me gruan dhe fëmijët e vet, po aq ka edhe me prindërit dhe vëllezërit e motrat e tij.

ah. Funksioni i rekreimit: Një funksion i këtyllë në literaturën sociologjike njihet me emrin vlerësimi i kohës së tretë, pra të lirë. Anëtarët e familjes lozin e argëtohen së bashku, po edhe mërzhiten dhe ngushëllohen së bashku.

1. b. Familja bërthamë (e vogël) dhe funksionet e saj:

Familje bërthamë quhet familja që përbëhet prej babait, nënës dhe fëmijëve të pamartuar. Në Perëndim ky lloj familjeje është paraqitur pas revolucionit industrial. Kurse sot, tiparet e familjes bërthamë i bart familja e shoqërisë qytetare. Krahasuar me familjen tradicionale, ajo ka funksione më të reduktuara. Sipas sociologut amerikan Talcot Parsons, familja bërthamë është një familje e specializuar, e profesionalizuar.

Ajo ka dy funksione bazë e më të rëndësishme: **funksionin biologjik** dhe atë **psikologjik**. Funksionet e tjera që ishin karakteristike për familjen tradicionale ose janë zhdukur tërësisht ose u është zvogëluar e reduktuar ndikimi dhe efekti. Elementi nënë dhe baba bëjnë kualifikimin e familjes sipas kushteve e rrethanave shoqërore që ndryshojnë vazhdimisht. Parapëlqimi personal dhe i ndërsjellë që i bashkon bashkëshortët, gradualisht sjell me vete edhe demokratizimin brendafamiljar.²

² Doğan, po aty, f. 198-200.

II. FAMILJA NË PERËNDIM

Në shoqëritë perëndimore familja ka luajtur një rol aq të rëndësishëm sa i ka përcaktuar edhe dimensionet kulturore, politike dhe ekonomike të Perëndimit. Në këtë kuptim, ekziston mundësia që Perëndimin ta ndjekësh e vëzhgosh në procesin e saj historik duke e futur atë brenda kornizës së familjes. Në vitet e para të Mesjetës, institucioni i martesës është nxitur e mbështetur nga ana e Kishës; ajo është paraqitur si një institucion serioz dhe origjinal në gjithë kompleksitetin e Perëndimit. Para revolucionit industrial, njerëzit e Perëndimit kanë jetuar një jetë të thjeshtë. Në këtë kohë familja ka qenë qendër e vëmendjes, e kujdesit dhe e ekzistencës. Burrat kanë shkuar në punë për të siguruar jetën, kurse gratë janë kujdesur për rritjen e fëmijëve krahas punëve të tjera të shtëpisë.

Përderisa në shoqërinë feudale familja ka jetuar me madhështinë e aristokracisë, me paraqitjen e industrializmit ajo ka filluar të shturet. Termi ‘familja bërthamë’ për herë të parë ka hyrë në literaturë si rezultat i këtij seruvani që e ka përjetuar Perëndimi. Familja moderne në Perëndim i përjeton thellë ndikimet e industrializmit e të post-industrializmit. Një nga pasojat e para të nevojës që njeriu ka patur për industrinë, ka qenë shpërngulja e burrave, grave e fëmijëve nëpër qendrat industriale, nëpër entet qeveritare, nëpër shtëpitë tregtare e në institucione të tjera të mëdha. Jeta ndryshon me të madhe dhe kërkon një angazhim më të madh për një jetë më të mirë e më luksoze.

Ky ndryshim në jetën ekonomike e sociale i ka dobësuar edhe lidhjet familjare. Në masë të madhe shuhet ëmbëlsia shpirtërore dhe kujdesi. Femrat e kanë ndjerë vetveten të humbura pa simpati modeste ndaj familjes dhe edukimit të fëmijëve, që ishte preokupimi i vetëm i tyre në kohët e mëhershme. Ato tani e harxhojnë gjithë energjinë e tyre në punën e rëndë në fabrikë. Roli i dyfishtë i gruas, si punëtore dhe nënë, është treguar si tepër i rëndë. Ka munguar koha e duhur dhe mundësia adekuate për prehje e qetësi shpirtërore dhe për qeverisjen e jetës shtëpiake.

Më tej, ‘liria’ absolute për punë, jetën familjare e ka kthyer së mbrapthi, duke e hedhur në erë ndershmërinë e pastërtinë, si vlera triviale e banale për zëvendësim me katastrofën dhe përdhosjen në jetën morale të familjes e të bashkësisë shoqërore, e cila ka qenë mbështetur në fenë e në virtytin. Batica në rritje e sipër e shkurorëzimeve, botën e qytetëruar e çon drejt një kursi të rrezikshëm, kurse familja me pashpresë e shikon pamundësinë e saj për t’i dalë në fund kësaj. Një dallim i vogël në mendime midis burrit e gruas konsiderohet si arsye e mjaftueshme për ndërprerjen e jetës bashkëshortore.

Shkrimtari rus Tolstoi ka pas shkruajtur: “Një nga arsyet kryesore për shkallën e lartë të shkurorëzimeve është liria e gruas për të vendosur lidhur me divorcin, duke e marrë parasysh karakterin e saj të butë dhe natyrën e saj shpërthyesë. Gjithashtu nuk duhet shpërfillur as edhe arsyet e tjera, si rraskapitja

dhe tensioni nervor i burrit dhe i gruas për shkak të kushteve të rënda të punës në industri, pastaj përzierja e burrave me gratë në punë, që është një rast shumë i volitshëm për marrëdhënie jashtëmartesore. Prej këtu buron edhe mosdurimi i bashkëshortëve. Një prej arsyeve është edhe punësimi i gruas jashta shtëpisë...”³

Këto dhe pasoja të tjera si këto, shkaktojnë shkrimin e titujve kryesorë nëpër gazeta e revista, si “Ka ndryshuar tabloja familjare në Perëndim”, “Në Evropë po siset familja” etj., që lajmërojnë problemet e shumta dhe serioze të familjes evropiane.

Duke u nisur që nga “Shoqatat për ruajtjen e jetës familjare” e deri te pullat dhe reklamat që e nxisin jetën familjare të mbështetura nga qeveri të ndryshme, të gjitha këto tregojnë për gjendjen serioze të familjes me të cilën ndeshet Perëndimi.

Një artikull i botuar në gazetën turke laike e proevropiane *Milliyet* të datës 23. 2. 1993, tregon se viteve të fundit në Perëndim modeli familjar ka pësuar ndryshime të mëdha dhe se ai ka filluar të shturet. I titulluar “Mbaroi familja në Evropë”, ai sjell këto konstatime:

“Koncepti familje në 20 vitet e fundit në Evropë ka pësuar një ndryshim shumë të madh...

Sot në Gjermani çdo i treti person jeton i vetmuar. Çdo e treta martesë përfundon me shkurorëzim. Çdo i katërti fëmijë rritet pa nënë ose pa baba...

Paramendohet që në vitin 2050 qytetet do të mbushen me rrokaqiej të përbërë prej banesah për një person, e do të mbyllen çerdhet për shkak të numrit të pamjaftueshëm të fëmijëve...

Sipas statistikave, 8 ose 9 % e çifteve të martuara nuk dëshirojnë fëmijë.

Në Gjermani çdo 100 gra në vit lindin 129 fëmijë. Kurse në vitet 1960 shkalla e lindshmërisë ka qenë dyfish më e lartë se e sotmja. Që të mund popullsia gjermane ta ruajë nivelin e sotëm që ka, duhet që çdo 100 gra të lindin 260 fëmijë në vit.

Në Gjermani është regjistruar rritje e numrit të atyre që janë martuar nga disa herë. Nga çdo i dhjeti çift që martohen e ndahen, tetë prej tyre martohen sërish. Në secilin prej tri çifteve të martuara, del se njëri prej bashkëshortëve njëherë ka qenë i martuar edhe më parë.

Vërehet rritje edhe në numrin e atyre që i ikin martesës. Këta persona, në vend që të martohen e pastaj të shkurorëzohen, parapëlqejnë të jetojnë bashkë si dashnorë. Në vitin 1972, në Gjermaninë Federale, numri i atyre që kanë jetuar së bashku ka qenë 137 000. Sot numri i këtyre çifteve ka arritur shifrën prej 963 000. 107 000 prej tyre jetojnë me fëmijë jashtëmartesore.

³ Sayid Mujtaba Rukni Musawi Lari, *Islam i zapadna civilizacija*, bot. Obzorja, Sarajevë, 1998, f. 53-54.

Në Gjermani numri i atyre që nuk martohen e që kanë fëmijë dhe që fëmijën e rrisin vetë, e tejkalon shifrën prej 1.8 milionë. 290 000 prej këtyre janë burra me fëmijë.


Në Evropë është paraqitur edhe një stil jete shumë i ndryshëm. Pasi burri të ndahet prej gruas dhe gruaja prej burrit, parapëlqejnë që jetën e re ta vazhdojnë me një person të gjinisë së njëjtë si ata vetë. Me këtë rast, fëmijët e lindur nga martesa e parë tani bëhen anëtarë të një familjeje shumë tjetër.

Paramendohet që në Evropë do të zhduket sistemi familjar, por nuk do të zvogëlohet numri i nënave dhe baballarëve që do të jetojnë vetëm me fëmijët”.⁴

Sigurisht që përvoja perëndimore që u përshkrua këtu, na ofron rezultate të rëndësishme. Konceptimi modern i urbanizmit, rritja e përqindjes së kundërvajtjeve, zvogëlimi i vazhdueshëm i komunikimit fytyrë më fytyrë, rëndësia që i jepet ruajtjes së jetës private, madje kur është në pyetje dashuria – avancimi i jetës njëbashkëshortore duke qenë si shkak SIDA..., të gjitha këto njerëzimit, me në krye Perëndimin, i japin vetëm një mesazh: “Qetësinë mos e kërkoni përjashta, por brenda! Për ta kërkuar e gjetur qetësinë brenda duhet të ekzistojë një ‘brenda’. Mbasi njeriu për nga natyra nuk mund të jetojë i vetmuar, kjo mund të realizohet vetëm nëpërmjet familjes”.

Në faqen në vazhdim do të keni mundësinë që përmes tabelës së paraqitur ta ndiqni trendin e transformimit që ka përjetuar familja në shoqërinë perëndimore.

⁴ Doğan, po aty, f. 228- 230.



Sqarimet⁵:

I – FAMILJE MODERNE

1. Familje ku punojnë edhe babai edhe nëna
2. Familje që takohen vetëm në fundjavë
3. Familje ku burri është amvis
4. Familje ku fëmijët i lihen një dadoje

II – ÇIFTE TË NDRYSHME

1. Familje e përbërë nga nëna dhe fëmija
2. Familje e përbërë nga babai dhe fëmija
3. Çifte homoseksuale

III - FAMILJE TRADICIONALE

1. Familje me shumë fëmijë ku burri punon jashtë e gruaja brenda shtëpisë

IV – FAMILJE PA FËMIJË

1. Familje prej çiftesh të vetmuara
2. Çifte pa fëmijë
3. Çifte që takohen në fundjavë

V – FAMILJE E NGJESHUR

1. Çifte që martohen, ndahen e rimartohen. Në familjet e reja i marrin edhe fëmijët nga martesat e parë.
2. Familje që jetojnë bashkë me njerëz që s'i kanë gjak e as fis

⁵ Doğan, po aty, f. 229.

III. FAMILJA TE MUSLIMANËT

A. FAMILJA NË BOTËN MUSLIMANE

Lloji më i theksuar i familjes që haset gjetu në botën islame është familja e gjerë dhe kryesisht patriarkale. Ajo është e lidhur ngushtë me mësimet dhe pikëpamjet kur'anore lidhur me familjen ngase, në masë të madhe, është brumosur e ngjeshur sipas tyre. Krahas pjesëtarëve të familjes bërthamë – babait, nënës dhe fëmijëve të pamartuar – familja muslimane përfshinë gjithashtu edhe gjyshin, gjyshen, mixhallarët, hallat dhe pasardhësit e tyre. Familjet muslimane zakonisht jetojnë në 'banesa të gjera', që do të thotë se anëtarët e tyre jetojnë bashkërisht nga tri ose më shumë gjenerata të afërmish në një objekt banimi ose kompleks banesash. Gjithashtu, aty ku ky version i banimit të familjes së gjerë nuk është i mundur, lidhjet familjare arrijnë larg familjes bërthamë, gjë që mund të shihet në lidhjet e fuqishme psikologjike, shoqërore, ekonomike, madje edhe politike.⁶

Tendencat individualiste e egoiste mjaft të përhapura në Perëndim, ku si rrjedhojë edhe është paraqitur familja e vogël e quajtur bërthamë, e shkaktuar nga zhvillimi e përparimi industrial e urbanistik, me të madhe kanë filluar të përhapen edhe në shoqëritë muslimane anekënd botës, megjithëse shumica prej tyre jetojnë në familje të gjera e të mëdha. Është ky një proces westernizimi (perëndimizimi) të cilin sa e propagandojnë vetë perëndimorët duke dashur që kulturën dhe qytetërimin e vet t'ia plasojnë botës si diçka universale, po aq i ndihmojnë edhe njerëzit dhe familjet muslimane të mahnitura nga mënyra e jetesës perëndimore, nga ai subjektivizëm i theksuar perëndimor.

Dëshira për të qenë i pavarur, për t'u distancuar nga familjet e gjera tradicionale muslimane, për ta shijuar jetën deri në fund sipas modeleve të huaja ka marrë hov thuajse në gjithë botën islame, e kryesisht nëpër qytetet më të mëdha të saj.

Në qoftë se si dy faktorë kryesorë për paraqitjen dhe lindjen e familjes bërthamë në Perëndim merren industrializmi dhe urbanizmi, këto dy dukuri shumë vonë kanë filluar të paraqiten në shoqëritë muslimane e në disa prej tyre të parin faktor, pra industrializmin, nuk e gjen as edhe sot bile. Por megjithëkëtë, jeta urbane, jeta nëpër qytetet e mëdha e metropolitane, ka kushtëzuar në njëfarë shkalle paraqitjen e familjes bërthamë edhe nëpër këto vende, duke mos e harruar gjithnjë atë ndikimin e kulturës perëndimore në këtë aspekt.

Krahas krejt këtyre tendencave për ndryshimin e strukturës familjare në botën islame, sërish mbetet i gjallë karakteri i saj i zgjeruar dhe tradicional, që ka mbijetuar nëpër shekuj. Mirëpo edhe krahas krejt kësaj që u tha sidomos në

⁶ Lois Lamya' al Faruqi, *Women, Muslim Society and Islam*, bot. American Trust Publications, Indiana –SHBA, 1994, f. 41.

fillim se ajo është e brumosur me tharmin e mësimëve islame lidhur me familjen, sërish në botën islame do të hasim familje muslimane me probleme të shumta e me mospërputhshmëri ndoshta edhe diametralisht të kundërta me mësimet e Islamit. Këtu ne u munduam ta përkrahim në vija të përgjithshme strukturën e familjes muslimane, duke e distancuar atë prej modelit e strukturës familjare që e parasheh Islami si tërësi. Prandaj, kur të flasim për familjen muslimane, për strukturën e saj dhe për problemet me të cilat ndeshet ajo, nuk duhet ngatërruar me mësimet e pikëpamjet e Islamit lidhur me këtë çështje. Duke u mbështetur në gjendjen faktike të muslimanëve nuk duhet gjykuar për Islamin si fe, porse duhet bërë dallimi midis Islamit si fe e sistem jete dhe muslimanëve si elementë që mundohen t'i ndjekin mësimet e kësaj feje, që vetvetiu nënkupton që jo gjithëherë e jo në çdo aspekt ata do të mund ta bëjnë këtë me sukses. Këtu dua të përkujtoj një thënie të njohur të hazreti Aliut, halifit të katërt pas Muhammedit a.s. (alejhi's-selam), i cili ka thënë: *“Mos vlerëso të vërtetën me fjalët dhe sjelljet e njerëzve, por njerëzit me kriteret e së vërtetës!”*.

B. FAMILJA TE MUSLIMANËT SHQIPTARË

Edhe te shqiptarët muslimanë haset pothuajse e njëjta strukturë familjare sikurse ajo e botës dhe trungut musliman. Edhe familja muslimane shqiptare ka strukturë të zgjeruar e të madhe me karakter tradicional, ku jetojnë së bashku nën një çati apo në një oborr disa breza e një shumësi anëtarësh. Përveç babait, nënës dhe fëmijëve të pamartuar, në shtëpinë shqiptare muslimane bashkëjetojnë edhe fëmijët e martuar me pasardhësit e tyre, vëllezërit e babait bashkë me pasardhësit e tyre dhe sigurisht që edhe gjyshi e gjyshja si anëtarë të parë e më të denjë të familjes. Nëpër qytetet shqiptare nuk kemi ndonjë sistem urbanistik aq të theksuar sikur në Perëndim i cili ka jetën dhe dinamikën e vet karakteristike, ku, si të thuash, pamundësohet ekzistimi i familjes së zgjeruar dhe i botëkuptimit tradicional të familjes. Në to vazhdon me të madhe të gjallërojë familja e gjerë me tiparet karakteristike të saj, krahas tendencës së përgjithshme që haset në botë për një pavarësim të rinjve sidomos nga pleqtë e nga anëtarët e familjes më të gjerë farefisnore. Edhe këtu, pra, ka filluar të bëhet çështje mode familja bërthamë me veçoritë e saj, por në mënyrë e stil lokal, ngase nuk mund të bëhet një shkëputje e menjëhershme dhe e tërësishme nga e kaluara dhe nga kornizat e struktura e familjes tradicionale që ka gjallëruar me shekuj të tërë në këto troje.

Me strukturën familjare dhe me problemet me të cilat ndeshet familja muslimane në përgjithësi dhe ajo shqiptaro-muslimane në veçanti, shpresojmë të merremi në një të ardhme të afërt në mënyrë pak më shkencore, për ta paraqitur më denjësisht e më realisht gjendjen në terren e për t'i ofruar zgjidhjet eventuale që do të përkojnë me frymën e kulturës e të mësimëve të përgjithshme kur'anore. Kjo më mbetet si barrë fillimisht mua dhe kolegëve të mi, po edhe atyre që mund të kontribuojnë në këtë drejtim, ngase shumë pak punime janë bërë në këtë kahje.

IV. FAMILJA NË ISLAM

A. PËRKUFIZIMI DHE PARIMET THEMELORE

Familja është një institucion i frymëzuar nga Zoti. Ajo nuk është zhvilluar nëpërmjet proceseve eksperimentale të evolucionit njerëzor e as rastësisht gjatë rrjedhës së kohës. Kjo është një e vërtetë e kumtuar nga mësimet hyjnore të shpallura nga Zoti dhe është një refuzim i tërësishëm i mësimëve evolucioniste dhe akcidentaliste të Çarls Darwinut e të ndjekësve të tij, sipas të cilëve jeta e njeriut ka filluar në ujë me bashkimin e rastësishëm të miliona proteinave për të krijuar qelizën e parë të jetës.* Familja është një institucion që është paraqitur e zënë fill me krijimin e njeriut. Raca njerëzore është prodhim i këtij institucioni, e nuk është institucioni prodhim i racës njerëzore. Lidhur me këtë Kur’ani fisnik thotë:

„O njerëz, bëhuni respektues të bindur të Zotit tuaj, i cili ju kroji prej një individi, kurse prej tij krijoi gruan, e ndërsa prej tyre krijoi dhe shpërndau shumë burra e grad he bëhuni të kujdesshëm në obligimin tuaj ndaj All-llahut, në emër të të cilit ju i drejtoheni njëri-tjetrit të bashkuar në një krah. Vërtet, All-llahu është Mbikëqyrësi juaj“ (en-Nisa’:1).

Sipas Islamit, pra, institucioni i familjes ka filluar me krijimin e burrit dhe gruas së parë, Ademut dhe Havës a. s., të cilët njëkohësisht e kanë përbërë familjen e parë, e jo që njerëzit e parë të zhvilluar e të evoluar nëpërmjet seleksionimit natyror nga qenie të tjera fillimisht të kenë jetuar të shpërndarë e të pabashkuar nëpër faqen e tokës e që më vonë duke u vetëdijësuar – përsëri nëpërmjet seleksionimit natyror – të jenë bashkuar e të kenë krijuar familjen. Islami këtë të dytën, teorinë e evolucionit, e hedh poshtë me ajetin e mësipërm dhe e mbështet faktin e krijimit të gjithësisë po edhe të njeriut dhe familjes së parë nga ana e Zotit.

* Më gjerësisht për mangësitë, mashtrimet dhe gjuhëzimin e teorisë së evolucionit, shih: Harun Jahja, *Gjuhëzimi i evolucionit – disfata shkencore e darvinizmit dhe e sfondit të tij ideologjik*, bot. Dielli I.C., Stamboll, 2001.

Institucioni i familjes ka qenë prezent që nga njerëzit e parë e deri më sot gjatë gjithë historisë njerëzore. Martesa dhe krijimi i familjeve ka qenë dukuri e hasur si te pejgamberët⁷ ashtu edhe te njerëzit e thjeshtë. Përfundimisht është edhe porosi e model i Muhammedit a.s., pejgamber i fundit i Zotit. Ai në një hadith të tijin thotë: “*Martesa është pjesë e sunnetit (rrugës) tim, kushdo që largohet nga sunneti im ai nuk është prej nesh*”.⁸

Institucioni i familjes luan rol të rëndësishëm në shoqërinë islame. Ajo është njësi themelore në atë shoqëri dhe është e organizuar në atë mënyrë që të veprojë si bashkësi në miniaturë. Përafërsisht një e treta e *Ahkamit* (rregullave juridike të Kur’anit) kanë të bëjnë me familjen dhe me rregullimin e harmonisë së saj. Është një gërshetim i tërë i të drejtave dhe obligimeve, që i sigurojnë themelet e jetës familjare e shoqërore në tërësi...

Familja islame, për sa u përket marrëdhënieve dhe obligimeve, dallon dukshëm nga familjet e tjera jomuslimane. Ajo nuk është familje bërthamë e përbërë vetëm nga prindërit dhe fëmijët, por është më e gjerë dhe nën kulmin e vet përfshinë tri ose katër gjenerata. Vështrimi i kujdesshëm për të drejtën trashëgimore, tregon se të gjitha marrëdhëniet janë pjesë integrale e strukturës familjare e jo diç periferike...

Besimi islam nuk pushon të luajë rolin vendimtar në sistemin e gjithmbarshëm të marrëdhënieve familjare. Biri musliman nuk mund ta trashëgojë babain jomusliman, por edhe babai musliman nuk mund ta trashëgojë pasurinë e djalit jomusliman. Po ashtu, nëse njëra palë bashkëshortore me kalimin e kohës e ndërron fenë, marrëveshja bashkëshortore konsiderohet e shfuqizuar. Prandaj, marrëdhënia martesore nuk është formë e thjeshtë e marrëdhënieve seksuale, ajo është bazë e ekzistencës shoqërore fetare.⁹

Këtu, sa i përket përkufizimit të familjes në Islam dhe llojit të familjes islame, mendoj se vlen të përmendim edhe reflektimet që i shpreh Dr. Hamude Abdulati. Ai, kur bëhet fjalë për përkufizimin e ‘familjes’, tërheq vërejtjen në vështirësinë e gjetjes së një përkufizimi të gjithëpranueshëm kur thotë se “Një pjesë e problemit, siç duket, është përkimi i paevitueshëm i kufijve të farefisnisë dhe të familjes, si dhe vështirësia karakteristike për tërheqjen e një vije përgjithësisht të pranuar të demarkacionit.

Për ta evituar këtë huti, do t’ju propozojmë një përkufizim veprues të familjes, ashtu siç do të përdoret ky term në kontekstin islam. Kështu i përkufizuar, termi familje do të përdoret për të emërtuar një lloj të veçantë të strukturës, parimet e së cilës janë të lidhur me njëri-tjetrin përmes lidhjeve të gjakut dhe marrëdhënieve bashkëshortore, dhe lidshmëria e të cilëve është e një

⁷ „*Ne kemi dërguar pejgamberë edhe para teje, o Muhammed. Ne u kemi caktuar atyre bashkëshorte dhe fëmijë (trashëgimtarë)*” (er-Ra’d:38).

⁸ Ibni Maxhe, *Sunen*, Libri mbi Nikahun (Kurorëzimin).

⁹ Ahmed Hurshid, *Jeta familjare në Islam*, Logos-A, Shkup, 1999, f. 22-28.

natyre të atillë, sa të kërkojë “kërkesa të ndërsjella”*, që janë të përcaktuara nga Feja, të përforcuara nga Ligji, dhe të sendërtuara nga individit.

Është e qartë se ky përkufizim është vendosur mbi kërkesat e ndërsjella që rrjedhin nga anëtarësia në një strukturë të tillë. Anëtarësia mund të atribuohet si rezultat i lidhjeve të natyrshme të gjakut, ose të fitohet përmes martesës, ose madje edhe të atribuohet dhe të fitohet nëse njësia e anëtarësisë përmban më tepër se një çift bashkëshortor**. Të drejtat dhe obligimet familjare nuk përcaktohen vetëm përmes lidhjeve të gjakut apo vetëm përmes marrëdhënieve martesore; këto dy kritere nuk janë as reciprokisht përjashtues e as domosdo plotësues...

Përkufizimi ynë i familjes nuk ka të bëjë me faktorin e banimit, për shkak se anëtarët e familjes mund të zënë apo edhe të mos zënë vendin e njëjtë të banimit. Sa u përket kërkesave të tyre të ndërsjella, nuk luan ndonjë rol të madh ajo se si dhe ku banojnë ata. Vendbanimi mund të ndahet (shfrytëzohet) nga të gjithë anëtarët, ose ata mund të jenë të ndarë dhe të pavarur. Ky fakt, ndër të tjerat, e bën të pamundur zbatimin e prerë të konceptit sociologjik të familjes bërthamore, ku uniteti i vendbanimit është njëra nga karakteristikat themelore në strukturën familjare në Islam.

Por nga kjo nuk duhet domosdo të vijojë se, pasi që familja në Islam nuk është tërësisht e tipit bërthamor, ajo duhet të jetë e “zgjeruar” ose “poligamike”. E as gjerësia as “poligjinia” nuk është parakusht apo domosdoshmëri për themelimin e familjes në Islam. Familja muslimane mund të jetë e zgjeruar, poligjinike, edhe e zgjeruar edhe poligjinike, apo si asnjëra prej tyre. Në Islam nuk ka kurrfarë kushtëzimi që familja të jetë e njërit apo e tjetrit lloj, njësoj siç nuk ka kurrfarë kushtëzimi në favor të, apo kundër llojit bërthamor të familjes. Forma e organizimit është një çështje e hapur, përkundër kërkesave të ndërsjella të anëtarësisë. Kërkesat e tilla mbeten, pa marrë parasysh se çfarë forme mund të marrë familja”.¹⁰

* Në vend të togfjalëshit mjaft të pavolitshëm “të drejtat dhe obligimet e ndërsjella”, “kërkesat e ndërsjella” do të përdoret për ta shënuar të njëjtën (shënim i vetë autorit H.A.)

** Këtu nuk e di pse autori nuk e ka përmendur edhe afërsinë e fituar nga qumështi, që në Islam është e një peshe të barabartë sikurse afërsia e gjakut?! – R.N.

¹⁰ Dr. Hamude Abdulati, *Struktura familjare në Islam*, bot. Logos-A, Shkup, 1995, f. 21-22.

B. STRUKTURA E FAMILJES ISLAME

“Edhe pse Islami nuk rekomandon kurrfarë lloji të veçantë të organizimit familjar, nuk ka dyshim se struktura tradicionale e familjes muslimane aktualisht ka qenë më afër llojit të zgjeruar sesa atij bërthamor. Kjo me siguri është rezultat i vazhdimësisë, e jo rezultat i ndonjë risie nga muslimanët. Islami nuk e përshkruan llojin e zgjeruar të familjes më tepër se që e ndalon atë. Nëse ka ngjarë që organizimi familjar në shoqërinë muslimane e ka pranuar, apo më mirë e ka vazhduar këtë formë të zgjeruar, nuk ekziston kurrfarë klauzole që atij t’i jepte një miratim apo mospëlqim universal. Mirëpo, pavarësisht se a ishte gjerësia e strukturës së familjes muslimane funksion i vazhdimësisë historike apo i kushteve të tjera shoqërore, Islami në dukje e pranoi këtë formë dhe nuk mori kurrfarë qëndrimi tjetër për të, për dallim nga qëndrimi i tij për aspekte të tjera të ndryshme të familjes.


Ky zhvillim historik, bashkë me përshtatjen shoqëruese fetare, mund të jetë mjaft sugjerues. Sepse, derisa Islami në asnjë rast nuk qe krejtësisht indiferent ndaj kushteve shoqërore dhe paraprijësve të tyre, ai në dukje nuk pa kurrfarë nevoje të veçantë për ta kufizuar strukturën familjare në cilëndo formë përjashtuese, qoftë ajo e zgjeruar, bërthamore apo poligjinike. Kjo mund të na tregojë se format e tilla në vetvete nuk janë vendimtare për konceptin islam të solidaritetit familjar dhe të kohezionit shoqëror, që të dyja këto janë me rëndësi parësore për Islamin, dhe se theksi nuk duhet vënë mbi formën, por më tepër mbi komponentet e sjelljes. Në të vërtetë, të drejtat dhe obligimet familjare në Islam janë të pavarura dhe të dallueshme nga format organizative të familjes; të parat janë të fiksuara ndërsa të dytat janë të hapura dhe të adaptueshme.

Qëndrimi i Islamit në këtë drejtim rrodhi, apo së paku është në përputhje me një pikëpamje të përgjithshme që duket se presupozon vazhdimësinë e paraardhësve deri në atë masë derisa ata nuk përdhunojnë disa parime të caktuara apo derisa nuk bien në konflikt me kërkesat themelore. Kështu, po e patëm parasysh se familja e zgjeruar patjetër nuk e përjashton llojin bërthamor, së paku si nënsistem, duket se Islami e ka konsideruar formën e zgjeruar të familjes të pranueshme, edhe pse jo edhe të domosdoshme. Kjo formë në dukje ka qenë vepruese dhe e veprueshme. Islami e përkrahu atë, edhe pse nuk insistoi që ashtu të jetë apo të mos jetë gjithmonë.

Fakti se Islami e përshtati llojin e zgjeruar të familjes dhe se nuk bëri kurrfarë specifikimesh të mëtejshme mund të sugjerojë se, nën kushte të caktuara, siç ishin ato që e rrethonin ngritjen e Islamit, struktura e zgjeruar e familjes do të duhej të jetë më shumë ndihmuese, edhe pse jo pashmangshmërisht, për të gjitha ato funksione, të cilave do t’u shërbente familja. Fleksibiliteti i formës organizuese, nga njëra anë, dhe veçantia e kërkesave të ndërsjella të anëtarëve, të përcaktuara nga feja, nga ana tjetër, do të mund të tregonte se struktura e familjes muslimane është kuptuar, ose mund të

kuptohet si pjesërisht hyjnore dhe e fiksuar, e pjesërisht njerëzore dhe e ndryshueshme.”¹¹

Nëse e marrim formën tradicionale e të zgjeruar të familjes islame, ajo do të kishte këtë pamje:



¹¹ Po aty, f. 31-32.

C. FUNKSIONET DHE QËLLIMET E FAMILJES¹²

Si duhet vepruar në familjen, që Islami dëshiron ta konstitujë për ta plotësuar ajo detyrën e saj në jetën e individit dhe të shoqërisë? Familja nuk është fabrikë për shtimin e gjinisë njerëzore. Familja në përgjithësi, edhe pse mbajtja, degëzimi dhe shtimi i sojit të njeriut janë ndër qëllimet e saj kryesore, ka strukturë shoqërore-kulturore dhe luan rol të rëndësishëm në ruajtjen e mekanizmit për të siguruar stabilitet shoqëror, ideor dhe kulturor në zhvillimin e gjithmbarshëm të shoqërisë.

1. Ruajtja dhe vazhdimësia e racës njerëzore

Ruajtja e racës njerëzore, e civilizimit dhe e vazhdimësisë së saj në funksion të njeriut si mlekëmbës i Zotit, varet nga operativiteti i mekanizmit për lindje dhe shtim. Natyra është e përgatitur për gjëra të këtilla, ku dallimi psikologjik dhe fiziologjik ndërmjet gjinive plotëson njëri-tjetrin. Vazhdimësia e racës në procesin e vet kërkon strukturë stabile, që vepron në mënyrë të organizuar. Burri, gruaja dhe fëmijët kanë nevojë të përhershme për vendosjen e rregullimit që do ta përmbushë këtë funksion. Kur'ani thotë:

„O njerëz, bëhuni respektues të bindur të Zotit tuaj, i cili ju kroji prej një individi, kurse prej tij krijoi gruan, e ndërsa prej tyre krijoi dhe shpërndau shumë burra e grad he bëhuni të kujdesshëm në obligimin tuaj ndaj All-llahut, në emër të të cilit ju i drejtoheni njëri-tjetrit të bashkuar në një krah. Vërtet, All-llahu është Mbikëqyrësi juaj“ (en-Nisa':1).

„Gratë tuaja janë si arat për punim, ndaj qasjuni arrave tuaja kujdesshëm dhe kujdesuni për atë që është e juaja dhe jini të vetëdijshëm e besnikë ndaj Zotit, dijeni se do të takoheni me Të!“ (el-Bekara:223).

¹² Ahmed Hurshid, po aty, f. 29 - 43.

2. Mbrojtja e moralit

Epshi seksual është gjë e natyrshme që është krijuar si çytje. Edhe pse kjo është cilësi e përbashkët për të gjitha qeniet e gjalla, te burri dhe gruaja ekzistojnë disa aspekte specifike. Te qeniet e tjera më me rëndësi është lindja, që rregullohet me anë të instinktit dhe ky është një proces natyror. Ato nuk janë të afta për sendërtimin e atyre nxitjeve epshore në çdo kohë, por këto nxitje te ato paraqiten në intervale sezonale ose gjatë ndonjë cikli të caktuar.

Nërkaq, te gjinia njerëzore nuk kemi të bëjmë me raste të këtilla. Shtytja epshore te njeriu ekziston përherë, duke i munguar mekanizmi i sendërtuar psikologjik për kontroll.

Islami i ndalon marrëdhëniet jashtëmartesore në të gjitha format e tyre. Marrëdhëniet seksuale nëpërmjet bashkësisë martesore janë i vetmi mekanizëm që siguron kontrollin e plotë në ngatërresat seksuale. Martesa gjithashtu është edhe një ventil sigurimi për moral seksual. Ku'ani martesën e quan *hisn* – kështjellë, për mbrojtje nga mënyra e shfrenuar e jetës dhe thotë:

„Kurorëzohuni me lejen e prindërve të tyre dhe jepni dhuratat tuaja me mirësjellje, si grave që kanë dinjitet të vetin, e jo si atyre të pamoralshme dhe atyre që sillen shfrenueshëm!“ (en-Nisa':25).

3. Stabiliteti psiko-emocional, dashuria dhe mirësjellja

Një funksion e qëllim tjetër i martesës është kultivimi i miqësisë psiko-emotive dhe shpirtërore. Marrëdhëniet në familje, ndërmjet të gjithë anëtarëve të saj, janë faktori më i rëndësishëm, veçanërisht ndërmjet burrit dhe gruas, por jo si marrëdhënie të nxitura nga interesi. Ato duhet të jenë marrëdhënie shpirtërore, ndarje e përbashkët e së mirës dhe së keqes, marrëdhënie që kultivojnë dashuri, mirësjellje, mëshirë, miqësi, besim të ndërsjellë, sakrifikim, ngushëllim dhe ndihmë në momentet vendimtare të jetës.

Vetëm në kuadër të familjes potenciali shpirtëror i burrit dhe gruas bëhet realitet dhe zhvillon pastërtinë morale brenda dhe jashtë familjes, do të thotë në shoqëri...Vlera e bashkëndjengjave në familjet me fëmijë kërkon dashuri dhe mëshirë, sakrifikim të njërit për tjetrin, tolerancë dhe dashuri për të formuar karakter të fortë te anëtarët e familjes. Kjo është familja që siguron klimë të përshtatshme për zhvillimin dhe kultivimin e karakteristikave të veçanta

njerëzore. Ky funksion i familjes dhe i martesës është trajtuar në shumë vende në Kur'an, ku thuhet:

“Dhe njëra prej shenjave të Tij (Zotit) është se Ai për ju krijoi gratë që të mund të pushoni pranë tyre dhe të gjeni prehje e qetësi në to, kurse ndërmjet jush vendosi dashurinë dhe mëshirën” (er-Rum:21).

Në një vend tjetër rporti ndërmjet bashkëshortëve është përshkruar si raport i afrisë ndërmjet “trupit dhe robave”:

„Ato (gratë tuaja) janë si rrobat tuaja dhe ju jeni si rrobat e tyre“ (el-Bekara: 187).

Ky theksim i identitetit dhe veçantisë së tyre është diç më i lartë se barazia ligjore. Burri e gruaja përshkruhen si rroba të njëri-tjetrit, e jo që njëri të jetë trup e tjetri rrobë. Rrobat e kënaqin atë që i vesh. Njeriu pa veshje ndjen mungesë fizike. Burri dhe gruaja e plotësojnë njëri-tjetrin, njëri e përsos, e plotëson dhe e bën të lumtur tjetrin. Një raport i këtillë e mbron moralin. Pa të, njeriut i kërcënohet rreziku i humbjes dhe i sjelljes jashtë normave ligjore.

4. Shoqërorizimi dhe orientimi i vlerave

Funksioni i shtimi në botë pa gjininë tjetër (babain), arsimimi dhe edukimi i fëmijëve, shkollimi i tyre, orientimi jetësor, formimi i karakterit, ndikimi gradual i kulturës dhe i besimit do të mbeteshin të mangët dhe jo të plotë. Kjo është kështu për arsye se ky aspekt i familjes mbetet kujdes i prindërve deri në moshën madhore të fëmijës. Kuurfarë institucioni tjetër, qofshin edhe disa institucione, nuk do të mund të ndërmerrnin një kujdes të këtillë për këtë funksion – edukimin e fëmijës.

Është i gabuar mendimi se kujdestarja, çerdhja, shkolla dhe vendi i punës, që zbatohen në shoqërinë moderne, mund të bëhen zëvendësim i plotë i edukatës familjare.

All-llahu xh.sh. thotë:

...

“O ju që besoni, mbrojeni veten dhe familjen tuaj prej zjarrit (të Xhehennemit), lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurëzit!...”(et-Tahrim:6).

Për rolin e familjes, si bartëse themelore e shoqërisë, na udhëzon edhe Muhammedi a.s. në hadithe të shumta, ku ai thotë se çdo foshnje e lindur lind në Islam, por prindërit e saj mund ta shndërrojnë atë në besim tjetër ose në pabesim. Ai gjithashtu ka thënë: *“Çdo baba mund t’i japë fëmijës së vet mësimin dhe arsimimin më të mirë”*. *“Çdokush që i furnizon tri vajza apo tri motra dhe u jep arsimim dhe edukim të mirë dhe sillet mirë me to, Zoti do t’i ndihmojë që ai të forcohet në këmbë të veta dhe me ndihmën e mëshirës së Zotit të fitojë vendin në Xhennet”*.

5. Sigurimi shoqëror dhe ekonomik

Familja është pjesë e rëndësishme e sigurimit shoqëror dhe ekonomik të sistemit islam. Drejtësia vendos raportet ndërmjet vlerave morale, kulturore dhe ideore, duke shtuar edhe drejtësinë ekonomike-shoqërore ndërmjet anëtarëve të familjes.

All-llahu xh. sh. thotë në Kur’an:

„Dhe martoni të pamartuarat (e të pamartuarit) edhe robërit e robëreshat tuaja që janë të ndershëm e të ndershme! Nëse janë të varfër, All-llahu i begaton nga mirësia e Tij. All-llahu është bujar, i gjithdijsëm“ (en-Nur:32).

Të këtij karakteri janë edhe mjaft ajete të tjera kur’anore që flasin për kujdesin dhe interesimin që duhet treguar ndaj anëtarëve të familjes si dhe ndaj farefisit të ngushtë e të gjerë.

Muhammedi a.s. thotë: *“Kur Zoti t’ju dhurojë ndonjë begati, shpenzoheni për vete dhe për familjen tuaj!”*.

a. Mbajtja e familjes është detyrë ligjore e burrit, bile edhe atëherë kur gruaja është e pasur.

b. Ndhma ndaj të afërmeve është e urdhëruar me rregulla të veçanta. Të afërmit e varfër kanë të drejtë në radhë të parë në zekat dhe në kontribute të tjera, që janë të detyruar t’i japin anëtarët e pasur të familjes.

- c. E drejta trashëgimore i rregullon obligimet ekonomike brenda strukturës familjare. Këto obligime materiale shtrihen edhe në farefisën e afërm e të largët.
- d. Fëmijët e adoptuar bonjakë duhet trajtuar si fëmijën e vet.
- e. Anëtarët më të vjetër të familjes duhet nderuar e duhet sjellur me kujdes e fisnikëri, dashuri e respekt ndaj tyre.
- f. Gjithashtu duhet sjellur me përgjegjësi ndaj fëmijëve dhe nipave.
- g. Qëndrim përgjegjës duhet pasur edhe ndaj anëtarëve të familjes së bashkëshortit e të bashkëshortes.

6. Zgjerimi i horizontit familjar dhe krijimi i kohezionit shoqëror në bashkësi

Bashkësia martesore po ashtu përvijon drejt zgjerimit të marrëdhënieve individuale, duke zhvilluar afrinë ndërmjet grupeve të ndryshme dhe të shumanshme, ndërmjet familjeve, fiseve e popujve. I Dërguari i Zotit thotë: “Lidhjet martesore ndërmjet dy familjeve apo fiseve e forcojnë miqësinë më shumë se çdo gjë tjetër”.¹³

Lidhjet martesore janë si ura ndërmjet familjeve, fiseve e bashkësive të ndryshme dhe instrument që me zgjerimin e marrëdhënieve familjare vendos barazinë ndërmjet njerëzve.

7. Motivi për përpjekje dhe sakrificë

Martesa në mënyrë të drejtpërdrejtë frymëzon zhvillimin e ndjenjave për përgjegjësi dhe nxit hapat për përpjekje më të madhe në plotësimin e nevojave jetësore dhe përmirësimin e zhvillimit ekonomik. Këto aspekte gjenden edhe në porositë e Kur’anit, që i nxisin njerëzit të martohen, ku thuhet:

...

“Dhe marotoni të pamartuarat (të pamartuarit) edhe robërit e robëreshat tuaja që janë të ndershëm e të ndershme...” (En-Nur:32).

Anëtarët e familjes, pra, duhet të integrohen brenda saj, kurse anëtarët e moshës madhore nuk do të duhej të iknin nga anëtarët e moshuar të familjes. Bonjakët, vetëm atëherë kur është e domosdoshme, duhet strehuar në jetimore. Të varfërin dhe të papunësuarin nuk duhet lënë të jetojnë nga lëmosha. Të gjitha

¹³ *Mishkat*. (Kjo nuk është vepra *Mishkatu’l-Envar* e Ebu Hamid el-Gazaliut, por vepra *Mishkatu’l-Mesabih* e Shejh Wal al-Din Muhammed Tebriziut, që në fakt është një edicion i ripunuar dhe i zmadhuar i veprës *Mesabihu’s-Sunneh* e Shejh Ebu Muhammed Husejn el-Begaviut dhe që nga dijetarët e Hadithit është e njohur për vlerën akademike që ka ajo – R.N.)

këto probleme të përshkruara si shembuj të zënë në gojë, gjejnë zgjidhje brenda familjes së rregulluar, që duhet të jetë humane dhe fisnike në plotësimin e nevojave të çdo individi. Ky nuk është vetëm sakrifikim ekonomik, por edhe kujdes i obligueshëm për të gjithë, ndjenjë ndaj nevojave dhe furnizimit të tyre.¹⁴

¹⁴ Familja është lidhja e parë në sistemin islam të mbrojtjes. Lidhjet e tjera i inkuadrojnë institucionet shoqërore dhe sistemin e drejtësisë në sistemin e përgjithshëm të mbrojtjes për të gjithë.

PËRMBYLLJE

Duke u nisur nga nevoja për të folur mbi familjen si një ndër institucionet bazë të shoqërisë, e cila në shoqëritë islame në përgjithësi e në atë shqiptare në veçanti ka filluar të tregojë disa transformime, e pamë të arsyeshme që kësaj teme t'i qasemi nga një aspekt më i gjerë, sidomos nga ai sociologjik, ku familja përkufizohet si *“një institucion shoqëror që e siguron vazhdimin e llojit njerëzor si pasojë e marrëdhënieve biologjike, ku për herë të parë paraqitet procesi i socializimit, ku marrëdhëniet e ndërsjella lidhen me disa rregulla e norma, ku bëhet bartja (përcjellja) e pasurive dhe vlerave materiale e shpirtërore nga brezi në brez dhe që ka dimensionin e saj biologjik, psikologjik, ekonomik, shoqëror, juridik e të ngjashëm”*.

Folëm për llojet e familjes si dhe funksionet e llojeve bazë që hasen sot, duke kaluar pastaj te karakteri i familjes perëndimore sot, që karakterizohet si një familje moderne, me formë të ngushtë, bërthamore dhe pastaj kaluam edhe te familjet muslimane dhe shqiptare, të cilat përgjithësisht karakterizohen si familje të gjera, të mëdha e tradicionale.

Në kapitullin e fundit folëm për familjen islame, pra ashtu siç parashihet të jetë në sistemin islam, duke folur për llojin, karakterin e saj, për strukturën si dhe për funksionet bazë të saj.

Ajo çka më ka rënë në sy më tepër është se në literaturën islame shqiptare shumë pak, për të mos thënë aspak, është shkruar për familjen ku ajo të jetë trajtuar nga aspekti i shkencave shoqërore, humane dhe në një nivel vërtetë shkencor. Përrjashtim bëjnë dy përkthime nga gjuha angleze: libërthi i Dr. Ahmed Hurshidit, JETA FAMILJARE NË ISLAM, bot. Logos-A, Shkup, 1999 (ky është përkthyer nga gjuha boshnjake) si dhe vepra voluminoze e Dr. Hamude Abdulatit, STRUKTURA FAMILJARE NË ISLAME, bot. Logos-A, Shkup, 1995.

Të shpresojmë që në të ardhmen të paraqiten punime të mirëfillta shkencore në këtë drejtim.

Literatura e konsultuar:

- Ahmed Hurshid, *Jeta familjare në Islam*, bot. Logos-A, Shkup, 1999 si dhe versioni origjinal në anglisht: Khurshid Ahmad, *Family Life in Islam*, bot. The Islamic Foundation, Leicester, UK, 1994.
- Bashkësia Islame e Kosovës, *Takvimi*, Prishtinë, viti 2003.
- Hamude Abdulati, *Struktura familjare në Islam*, bot. Logos-A, Shkup, 1995.
- İsmail Doğan, *SOSYOLOJİ – Kavramlar ve Sorunlar*, bot. Sistem Yayıncılık, Stamboll, 1998.
- Lamyā' al Faruqi, *Women, Muslim Society and Islam*, bot. American Trust Publications, Indiana – SHBA, 1994.
- Sayid Mujtaba Rukni Musawi Lari, *Islam i zapadna civilizacija*, bot. Obzorja, Sarajevë, 1998. (Ky libër është përkthyer edhe në gjuhën shqipe)